

**Dr. Tony B. Watlington Sr., Ed.D.**  
Superintendent

26 Gusht, 2022

Të Nderuar Familje & Nxënës, të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias

**Mirë se vini në vitin shkollor 2022-2023!** Të Hënën, më 29 Gusht, mezi pres t'i shoh klasat tona të mbushura me të rinj të emocionuar ndërsa ata rilidhen me miqtë, takojnë mësuesit e tyre të rinj dhe fillojnë një vit tjetër mësimi dhe zbulimi.

Si superintendent i ri, unë do të festoj "ditën time të parë" të shkollës këtu dhe mezi pres të nis këtë udhëtim të ri në partneritet me ju. Kam kaluar dy muajt e fundit duke dëgjuar dhe mësuar gjithçka që mundem për Drejtorinë Arsimore – çfarë kemi bërë mirë dhe çfarë mund të bëjmë për të përmirësuar. Ajo që kam dëgjuar vazhdimisht është një dëshirë e fortë për të punuar më mirë së bashku – *si partnerë të vërtetë* – për të përshpejtuar rezultatet e suksesshme për të gjithë studentët, pavarësisht vështirësive tona. Unë besoj se e vetmja mënyrë për të ecur përpara me sukses është *së bashku* dhe jam i përkushtuar ta bëj pikërisht këtë.

Jini të sigurt, ne kemi punuar shumë për t'i përgatitur shkollat tona për të takuar fëmijët tuaj, ku janë emocionalisht dhe akademikisht pas tre vitesh shumë të vështira me COVID dhe trauma të tjera. Ne do t'i rrethojmë ata me edukatorë të kujdesshëm dhe mbështetje social-emocionale që janë jetike për të rivendosur shëndetin dhe mirëqenien e tyre mendore. Ne do t'i përqafojmë ata në mjedise mësimore mikpritëse dhe gjithëpërfshirëse që i ndihmojnë ata të ndihen të vlerësuar si individë dhe të realizojnë potencialin e tyre të plotë. Ne do t'i bëjmë të gjitha këto në ndërtesa të pastra shkollore që janë të pajisura me dezinfektues dhe stacione hidratimi, pastrues ajri dhe mbështetje të tjera për të mbrojtur mirëqenien e të gjithëve në shkollat tona.

Në një farë mënyre, ky vit shkollor përfaqëson një fillim të ri emocionues për Drejtorinë Arsimore të Filadelfias. Do të dëgjoni më shumë në javët dhe muajt e ardhshëm për mundësi të reja që do të informojnë hapat e mi të ardhshëm, duke përfshirë zhvillimin e një plani strategjik agresiv pesë-vjeçar. Sigurohuni që të "[sign up for the parent portal](#)" ([regjistrohuni në portalin prindëror në](#)) mënyrë që të mund të merrni të gjitha përditësimet dhe njoftimet e rëndësishme kur vijnë.

Për t'ju ndihmuar të shijoni këtë fundjavë të fundit përpara fillimit të shkollës, miqtë tanë në Muzeun e Artit të Filadelfias po i ofrojnë personelit dhe familjeve tona **hyrje falas në Muze të Shtunën, 27 Gusht nga ora 10 e mëngjesit deri në 3 pasdite**. Mund të regjistrohuni për biletat tuaja [këtu](#).

Paçi një vit të ri shkollor të mrekullueshëm!



Tony B. Watlington Sr., Ed.D.  
Superintendent  
Drejtoria Arsimore e Filadelfias